



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primljeno Më/Dana 11-12-2011			
Nr. i organit Org. broj	Num. i Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
02-035/02	02	993	



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë

Opština Vitina

Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 lidhur me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491 të dates 21.04.2011, në harmoni me nenin 3 pika 1.4 dhe nenin 12 paragrafi 12.1, 12.2, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit për Fuqizim dhe Pjesmarrje të Rinisë Nr.03/L-145 lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr.11/2010 për Licencimin e qendrave Rinore, Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave dhe autorizimeve që ja lejon ligji bjen këtë:

V E N D I M

Për licencimin e Qendrës Rinore

Neni I

Qendra rinore ofronë hapësirë për programet dhe veprimtaritë e të rinjve në bazë të statutit të tyre, ndërsa janë të hapura për të gjithë të rinjtë.

Neni II

Qendra rinore e licencuar nga Drejtoria Komunale përgjegjëse Për Kulturë, Rini dhe Sport sipas llojit dhe natyrës së saj, duke marrë parasysh strukturën, programet dhe mundësitë për përmbushjen e detyrave që lidhen me zhvillimin fizik, mental, shoqëror dhe shpirtëror të të rinjve, ofron hapësirë, resurse dhe mundësi për zhvillimin e veprimtarive edukative joformale, si dhe të veprimtarive të tjera të planifikuara nga të rinjtë.